



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Bordi i Administrimit

Nr. 2559 Prot

Shkodër, më 28. 09.2020

V E N D I M

Nr. 301 datë 28.09.2020

**“ PËR MIRATIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONEVE ZGJEDHORE ”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, të rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve të autoriteteve drejtuese dhe senatin akademik në USH”, urdhërit të ministres së arsimit, sportit dhe rinisë nr.8, datë 14.01.2020 “Për procesin zgjedhor për autoritetet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë ( i ndryshuar), urdhërit nr.199, datë 30.06.2020 i rektorit të USH- së, për shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritete drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” vendimit nr.291 datë 24.09.2020 të senatit akademik, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 28.09.2020

**Vendosi:**

- Miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore si më poshtë:
  - Anëtarët dhe Sekretari i KIZ me 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë
  - Anëtarët e KA me 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë
  - Anëtarët e KZF me 40.000 (dyzet mijë ) lekë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Naim KOFLIKU**

